



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. *43/147-13* Prot.
Nr. Dok. 202300846/13

Tiranë *9* / *10* / 2024

Lënda: *Kthim përgjigje*

Drejtuar: **Z. Ismail Skeja**
Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa nr.24
Hyrja nr.3, Apartamenti 7

Tiranë

I nderuar z. Skeja,

Në letrën drejtuar Avokatit të Popullit, ju keni shprehur shqetësimin në lidhje me ecurinë e procesit të shpronësimit të një pasurie të paluajtshme në pronësinë tuaj të ligjshme, e cila preket nga ndërtimi i segmentit rrugor (vazhdim i unazës së Madhe), nga sheshi "Shqiponja" deri në "Bulevardin e Ri", në qytetin e Tiranës. Sikundër ju shkruani, kjo pronë e ligjshme, e llojit "Truall + Ndërtesë", është regjistruar në regjistrat kadastralë me nr. 35/62, z.k. 3976, me një sipërfaqe prej 572.7 m² dhe ndodhet në Njësinë Administrative nr. 3, të Bashkisë Tiranë.

Sipas jush, procedura e shpronësimit është bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 13.10.2022 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe të Tiranës, nga sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri" dhe "rikualifikimi i unazës lindore për lotet 4,5,6"" (faza 2)", (VKM nr. 662/2022). Në vazhdim të kësaj procedure, ju shkruani se jeni vënë në dijeni dhe njoftuar zyrtarisht me anë të shkresës nr. 482/5, datë 03.06.2022, të Komisionit të Posaçëm të Shpronësimeve (Agjencia Shtetërore për Shpronësim), për procedurën e filluar të shpronësimit të kësaj prone.

Ndërkohë, në datën 31.08.2023, ju shkruani se jeni njoftuar nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), se duhej të merrnit masa për lirimin e kësaj prone.

Lidhur me këtë fakt, ju shpreheni se shkresa e dërguar në këtë datë me titullin “Njoftim”, nuk ka një numër protokolli dhe se sipas saj, në datën 6.09.2023, IKMT-ja do të ndërhynte për prishjen e ndërtesës në pronësinë tuaj të ligjshme.

Jo vetëm kaq por ju shpreheni se, megjithëse kjo shkresë është dërguar në këto kushte, ligjërisht ju si subjekt nuk keni marrë njoftim pasi, në rubrikën “Marrësi”, nga ana e inspektorëve përkatës të IKMT-së është vënë shënimi, “u la në objekt”, dhe nuk ka asnjë kundërfimim siç edhe kërkon ligji.

Gjendur në këto kushte, ju keni ngritur pretendimin se veprimet e kryera nga ana e IKMT-së, janë ndërmarrë në kundërshtim me ligjin. Këto veprime janë kryer si të tilla në një kohë kur, ende nuk është kryer lëvrimi i pagesës (masës së dëmshpërblimit), nga organet përgjegjëse shtetërore në përputhje me parashikimet e VKM-së nr. 662/2022.

Kryerja e këtyre veprimeve konsiderohen nga ana juaj si abuzive dhe arbitrare, si dhe një zhveshje “de facto”, nga pronësia juaj e ligjshme.

Në këto rrethana ju keni kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, për sqarimin dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Lidhur me këtë ankesë tuajën ju sqarojmë se:

Me marrjen në shqyrtim të kësaj ankese është kërkuar dërgimi i shpjegimeve dhe i kopjes së dokumentacionit zyrtar të trajtimit të saj, nga dy organe publike, përkatësisht nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), si dhe nga ana e IKMT-së.

Për sqarimin e kësaj ankese, në kushtet kur Autoriteti Rrugor Shqiptar është subjekti përfitues që ka paraqitur kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive prone private, që preken nga ndërtimi segmentit rrugor “*Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimin të Unazës së Madhe nga sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri*” dhe “*Rikualifikimi i Unazës Lindore për lotet 4,5,6*” (Faza 2)”, kemi kërkuar nga ky organ publik të na jepet sqarime të detajuara lidhur me trajtimin e kësaj çështjeje. Në këto sqarime kemi kërkuar të na jepet informacion për fazën në të cilën ndodhet procesi i shpronësimit për pasurinë, prone private, të sipërcituar. Po kështu, kemi kërkuar të vihemi në dijeni të faktit nëse titullari i kësaj prone është dëmshpërblyer sipas përcaktimeve ligjore për këtë proces shpronësimi, apo jo. Në vazhdim kemi kërkuar shpjegime lidhur me faktin se, mbi ç’bazë organi i IKMT-së, iu ka dërguar juve si ankues shkresën e datës 31.08.2023. Pra, a ka pasur një kërkesë paraprake nga ana e ARRSH-së, për këtë qëllim drejtuar IKMT-së, apo jo? Kemi konsideruar të nevojshëm edhe dërgimin e një kopjeje të dokumentave zyrtare, në të cilat mbështeten shpjegimet dhe informacioni përkatës, që do ti dërgoheshin Avokatit të Popullit, lidhur me këtë çështje.

Nga ana e IKMT-së, kemi kërkuar të na dërgohen shpjegimet lidhur me pyetjet si vijon:

1. Mbi ç’bazë i është dërguar z. Skeja, shkresa e datës 31.08.2023?
2. Cili është organi publik i cili ka kërkuar ndërhyrjen tuaj në këtë fazë të procesit të shpronësimit, për prishjen e ndërtesës private në pronësi të ligjshme të z. Skeja?

3. Përse shkresës suaj të datës 31.08.2023 i mungon numri i protokollit dhe a është regjistruar kjo shkresë si e tillë në regjistrin e protokollit të shkresave, që iu dërgohen palëve të treta nga IKMT-ja?
4. A është ndërhyrë nga ana juaj në këtë rast, apo jo? Në rast të çdo përgjigjeje për këtë pyetje të na jepen arsyet ligjore, pse?

Veç shpjegimeve që do të jepeshin për pyetjet e sipërcituara, kemi kërkuar gjithashtu dërgimin e një kopjeje të dokumentave zyrtare, në të cilat mbështeten shpjegimet dhe informacioni përkatës që do të dërgoheshin nga ana juaj, lidhur me këtë çështje.

Në përgjigjen e dhënë nga ana e ARRSH-së, me shkresën nr. 7967/1 prot., datë 31.10.2023, na jepet informacioni se prona juaj e ligjshme është shpronësuar me VKM-në nr. 662/2022. Lidhur me likuidimin e vlerës së kësaj pasurie, ju keni depozituar një pjesë të dokumentacionit të nevojshëm për pagesë në datë 22.06.2023, ndërkohë sipas përgjigjes së ARRSH-së, plotësimi i tij është bërë në një datë të mëvonshme.

Për shkak të ezaurimit të fondit për shpronësimet, akorduar ARRSH-së, për vitin 2023, likuidimi juaj si subjekt i shpronësuar është pezulluar, thuhet në përgjigje, deri në miratimin e fondeve shtesë për buxhetin e vitit 2023. Nëpërmjet shkresës nr. 8408/1 prot., datë 25.10.2023 (administruar në ARRSH me nr. 8355 prot., datë 26.10.2023), të dërguar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me lëndë *“Mbi detajimin e fondeve buxhetore në zbatim të Aktit Normativ nr. 5, datë 18.10.2023”*, është konfirmuar rishikimi i buxhetit për vitin 2023, për të cilin është kërkuar fond shtesë për zërin *“Shpronësimet”*, me miratimin përfundimtar të të cilit, do të procedohet me pagesën e z. Skeja.

Në mungesë të përgjigjes së pritshme nga ana e IKMT-së, brenda afateve ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, jemi detyruar të përsërisim kërkesën tonë për shpjegime dhe koje dokumentacioni zyrtar me disa shkresa tona të tjera në vazhdim dhe më konkretisht, me shkresat nr. K3/I47-6 Prot., datë 07.11.2023, nr. K3/I47-7 Prot., datë 13.12.2023 dhe së fundmi me nr. K3/I47-8 Prot., datë 22.01.2024. Pas katër kërkesash për shpjegime dërguar prej nesh në këtë organ publik, na është dërguar për dijeni shkresa e ARRSH-së, nr. 674 prot., datë 22.01.2024, me anë të cilës na bëhet me dije fakti se ky organ po i kërkonte informacionin dhe kopjen e dokumentacionit të kërkuar prej Avokatit të Popullit, njërës prej drejtorive të tij rajonale dhe më saktësisht, Drejtorisë Rajonale të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Tiranë. Në vazhdim, na është dërguar për dijeni shkresa e ARRSH-së, nr. 835/1 prot., datë 01.02.2024, ku sërish i kërkohet nga ana e këtij organi publik, Drejtorisë Rajonale të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Tiranë, informacioni dhe kopja e dokumentacionit të kërkuar prej Avokatit të Popullit, lidhur me këtë çështje.

Për këto shkaqe, me shkresën tonë nr. K3/I47-11 prot., datë 14.05.2024, i kemi rekomanduar IKMT-së:

1. *“Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e detyrimit ligjor, për dhënien e informacionit Avokatit të Popullit.*
2. *Fillimin e procedurës administrative, për evidentimin e punonjësve përkatës përgjegjës të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, lidhur me*

mospërmbushjen e detyrimit ligjor, për t'i kthyer përgjigje kërkesave të Avokatit të Popullit, për dërgimin e informacionit të kërkuar, si dhe marrjen e masave administrative e disiplinore ndaj tyre.

3. *Marrjen e masave organizative që kjo shkelje të mos përsëritet në të ardhmen”.*

Në përgjigje të këtij rekomandimi, IKMT-ja ka dërguar shkresën nr. 835/3 prot., datë 03.06.2024, në të cilën ndër të tjera na sqarohet se nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, është kërkuar marrja e masave të menjëhershme për kryerjen e procedurave administrative, të ndërtimeve pa leje në proces legalizimi, si dhe njoftimi i subjekteve të interesuara për ndërtimet që preken nga segmenti rrugor “Unaza e Madh Tiranë, sheshi shqiponja – Bulevardi i Ri Tiranë – Shkozë”, ku Drejtoria Vendore Kamëz ka kryer verifikimet, sipas gjendjes faktike të ndërtimeve pa leje, të cilat preken nga ky segment.

Pas evidentimit faktik në terren të të gjithë objekteve që preken nga realizimi i segmentit rrugor të sipërcituar, është konkluduar për objektin në posedimin tuaj, nga ku është kërkuar marrja e masave për lirim të menjëhershëm të sheshit të ndërtimit në zbatim të ligjit. Në përgjigje thuhet në vazhdim se, IKMT-ja në bashkëpunim me organe të tjera publike, me qëllim lirim të sheshit të ndërtimit nga objektet që përbënin pengesë për realizimin e projektit ka nxjerrë aktet përkatëse administrative, të përshkruara me të dhëna të detajuara në përgjigjen e dhënë nga ky organ publik.

Në datën 30.08.2023, IKMT-ja konfirmon në përgjigjen e saj se ka bërë ndërhyrjen për prishjen e objektit në pronësinë tuaj të ligjshme.

Bashkëngitur përgjigjes së saj, IKMT-ja ka dërguar edhe një kopje të dokumentacionit zyrtar që lidhet me trajtimin e kësaj çështjeje nga ky organ publik, ndër të cilat kemi evidentuar edhe një kërkesë tuajën të datës 27.09.2023, drejtuar IKMT-së, ku këtij organi publik i silllet në vëmendje çështja administrative në shqyrtim, pranë gjykatës administrave, për shtetasin Ismail Skeja.

Për saktësimin e këtij fakti kemi kontaktuar në rrugë telefonike, me numrin që ju keni dhënë në ankesën tuaj për qëllim kontaktimi. Nga ana jonë është kontaktuar nëpërmjet këtij numri me avokaten Irena Dule, një prej avokatëve që iu përfaqësojnë juve në këtë çështje, me prokurën e posaçme, me nr. rep. 1590, nr. kol. 461, datë 11.04.2023.

Gjatë kësaj bisede telefonike është saktësuar fakti se në kuadër të shqyrtimit të themelit të kësaj çështjeje, është paraqitur një kallëzim penal, si dhe ka filluar shqyrtimi i një çështjeje civile në gjykatën administrative kompetente.

Në këto rrethana, në përputhje me nenin 14, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Avokati i Popullit mund të mos fillojë ose ndërpret hetimin në qoftë se e njëjta çështje është vendosur ose është në shqyrtim nga prokuroria apo gjykata...”,

ju bëjmë me dije ndërprerjen e shqyrtimit të mëtejshëm të kësaj çështjeje, në përputhje me kompetencat që Avokati i Popullit, gëzon në ligjin e cituar më lart, pasi do të jetë gjykata tashmë organi kompetent shtetëror që do të zgjidhë përfundimisht këtë çështje.

Pavarësisht këtij fakti sjellim në vëmendjen tuaj se, Avokati i Popullit në çështje të mëparshme të shqyrtuara nga ana e tij që lidhen me këtë problematikë, si edhe në raporte të veçanta, apo në raporte vjetore të veprimtarisë së tij drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, ka konstatuar se gjatë proceseve të shpronësimeve për interes publik të pronës private, organet publike sillen në mënyrë arbitare me titullarët e së drejtës së pronës/pronarët, pasi poseduesit zhvishen nga e drejta e pronësisë dhe nuk dëmshpërblehen/kompensohen paraprakisht, kundrejt një shpërblimi të drejtë dhe brenda afateve ligjore. Institucioni i Avokatit të Popullit mbetet i qëndrimit se shteti, nëpërmjet organeve publike, duhet të kujdeset për interesat pronësore të qytetarëve, në rast shpronësimi, duke pasur në konsideratë procesin e rregullt ligjor dhe nevojat social-ekonomike të tyre.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, bashkëngjitur kësaj shkrese do të gjeni një kopje të shkresës së ARRSH-së nr. 7967/1 prot., datë 31.10.2023, si dhe të shkresës nr. 835/3 prot., datë 03.06.2024, të IKMT-së, së bashku me kopjen e dokumentacionit zyrtar dërguar në to nga ana e këtyre organeve publike.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj,

KOMISIONERE

Erinda MELI

